



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDIM**

NR 33, DATË 30/04/2026

“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 101, DATË 22.12.2025 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT AFATMESËM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026” PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE TË TRASHËGUARA”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 30/04/2026 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për një shtesë në vendimin nr 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” për shpërndarjen e fondeve të trashëguara”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të VKB-së nr 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesat në vendimin nr 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” sipas aneksit nr.1, dhe nr.2, bashkëngjitur vendimit.
2. Të miratojë rritjen në buxhetin e vitit 2026 në vlerën 6,903,478 lekë sipas aneksit Nr 3 pika 1-4.
3. Të miratojë shpërndarjen për fondet e trashëguara në shumën 4,171,026.18 lekë sipas aneksit Nr 3 pika 5-6.
4. Të bëhet saktësimi i zërit buxhetor ‘Blerje projekti "Rikonstruksion i murit mbajtes dhe rrugëve "Tahir Kadare" dhe "Javer Hurshiti"’ në ‘Studim projektim ‘Rikonstruksion i murit mbajtes dhe rrugëve "Tahir Kadare" dhe "Javer Hurshiti”’.
5. Të bëhet saktësimi i zërit buxhetor ‘Blerje projekti "Prita malore në shtratin e përroit "Sopoti"’, në ‘Studim projektim ‘Prita malore në shtratin e përroit "Sopoti”’.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretar i Këshillit

Bexhet Baxhella

Adresa: Sheshi “Çerçiz Topulli”, Gjirokastër, Shqipëri. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424

